



REPUBLIKA E SHQIPËRI  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 54 prot.

Kamëz, më 19.04.2022

V E N D I M

Nr. 47 .Datë 19/04 2022  
M B I

**“ DISA NDRYSHIME NË VKB NR.66 DATË 25.06.2020 PËR MIRATIMIN E  
PROCEDURAVE PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT SOCIAL TË STREHIMIT  
“SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË “, I FINANCUAR ME FONDET E  
BUXHETIT TË SHTETIT ”**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 19.04.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.44 Datë 13.04.2022 në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 24, nenit 54 shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 15 dhe nenit 47, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, vendimit nr. 384, datë 12.06.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, vendimit nr. 453, datë 3.7.2019, të Këshillit të Ministrave “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti”, shkresës nr. 1237 Prot datë 24.01.2022 mbi fondet për programet e strehimit për vitin 2022 ; Këshilli Bashkiak Kamëz”;

V E N D O S I:

1. Procedurat për zbatimin e programit social të strehimit, "Subvencionimi i interesave të kredisë", i financuar me fondet e buxhetit të shtetit, sipas udhëzuesit operacional, të ndryshuar bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Sistemin e pikëzimit bashkëlidhur , këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

Kryetar Këshilli  
HYSËN KOLDASHI

